

Shuma kontribuuese

Tarifa e anëtarësimit të USDAW-it është një nga më të ulëtat në lëvizjen e sindikatave, e cila ju siguron një gamë përfitimesh dhe shërbimesh profesionale të cilësisë së lartë vetëm për disa cent në ditë.

Për më shumë informacion rreth USDAW-it dhe anëtarësimeve:

- Kontaktoni përfaqësuesin tuaj të USDAW-it
- Ose zyrën lokale të USDAW-it në numrin e telefonit:

0800 030 80 30

- Vizitoni faqen tonë të internetit:

www.usdaw.org.uk



Informacioni në këtë fletëpalosje konsiderohet i saktë në datën e printimit – 04/2026



Botuar nga Usdaw
Voyager Building
2 Furness Quay
Salford Quays
Manchester M50 3XZ

Albanian

A ndihesh...

i/e izoluar?

i/e pasigurt për të drejtat e tua në punë?

A dëshiron të mësosh gjuhën angleze?

USDAW-i mund t'ju ndihmojë – ne jemi përfaqësuesit e sindikatës suaj



Gjashtë arsye të mira për t'iu bashkuar USDAW-it – sindikatës suaj

Gjashtë arsye të mira për t'iu bashkuar USDAW-it...

- 1 Ne i ndihmojmë anëtarët tanë të informohen rreth të drejtave të tyre në punë. Për shembull: a e dinit se keni të drejtën e:
 - Pagës minimale për të rritur. Kjo rritet çdo vit dhe që prej 1 prillit, 2026, ka qenë:
£12.71 në orë për moshat 21 vjeç e lart
£10.85 në orë për moshat 18-20 vjeç
£8.00 në orë për moshat 16-17 vjeç
 - 28 ditë pushimi të paguara në vit (për punonjësit që punojnë 5 ditë në javë).
 - 11 orë pushimi në ditë.
 - Shumica e punonjësve kanë të drejtën e pagesës pas tri ditësh sëmundje.
- 2 Ne i marrim në shqyrtim problemet e anëtarëve me sektorin e menaxhimit dhe ju përfaqësojmë në seancat disiplinore.
- 3 Ne u ofrojmë anëtarëve tanë konsulencë ligjore FALAS dhe përfaqësim në rast të ndonjë aksidenti në punë, largimi të padrejtë dhe diskriminimi.
- 4 Ne mund t'i ndihmojmë anëtarët tanë të kenë akses FALAS në trajnime në fusha të ndryshme, përfshi gjuhën angleze, matematikën dhe aftësitë kompjuterike.
- 5 Ne organizojmë fushata kundër racizmit dhe promovojmë barazinë për të gjithë punonjësit.
- 6 Ne punojmë për të përmirësuar pagën e anëtarëve dhe mirëqenien në punë.

- Çdokush mund të anëtarësohet në sindikatë.
- Është e drejta jote ligjore për t'u anëtarësuar në një sindikatë.
- Nuk je i detyruar ta informosh punëdhënësin tënd që je anëtar i një sindikate.
- Është e jashtëligjshme të të diskriminojnë që je anëtar i një sindikate.